

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI EKONOMIK**



**EFEKTET E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT NË  
PËRFORMANCËN E TREGUT TË PUNËS NË  
EVROPËN JUGLINDORE**

**PUNIM I DOKTORATËS**

**Mentori:**

**Prof.Dr. Sinan Ademaj**

**Kandidatja:**

**MSc. Luljeta Elezaj**

**Prishtinë, 2019**

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"  
FACULTY OF ECONOMY



Luljeta Elezaj

**The effects of labour market policies on  
market labour performance in South -  
East Europe**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2019

## Abstrakt

Tregu i punës mbetet në qendër të kërkimeve akademike dhe diskutimeve politike në shumicën e vendeve. Tregjet e punës janë subjekt i goditjet makroekonomike, nacionale dhe ndërkombëtare, të cilat shpesh e bëjnë të vështirë përshkrimin dhe matjen e efektit të politikave të punësimit në kuptimin teorik dhe empirik. Diversiteti i tregut të punës në vende të ndryshme bën që shpesh politikat e punësimit të duken të paqarta dhe të njëjtat mund të kenë efekte të ndryshme në vend të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të zhvillimit. Ky punim paraqet një trajtim gjithëpërfshirës në aspektin teorik dhe empirik të politikave të punësimit lidhur me ndikimin e tyre në performancën e tregut të punës. Duke vënë në dukje zhvillimet e tregut të punës në vendet në tranzicion, vëmendje e veçantë i është kushtuar performancës relativisht të dobët të politikave të punësimit në vendet e Evropës Juglindore<sup>1</sup>, me fokus të veçantë në Kosovë. Duke përdorur të dhënat e fundit në dispozicion nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, së pari është bërë një analizë e gjendjes së përgjithshme e trendeve të zhvillimit të tregut të punës përfshirë papunësinë, punësimin, kostot sociale dhe ndikimin e politikave të punësimit në indikatorët kryesor të tregut të punës. Nga gjetjet e mëhershme shihet se praktika aktuale në vendet e Evropës Juglindore përfshinë vlerësime shumë të kufizuara dhe ofron vetëm njohuri themelore lidhur me efektivitetin e politikave të punësimit, pa përfshirë efektivitetin e tyre përgjatë kohës. Në këtë kontekst kemi bërë përpjekje për të matur në nivel agregat efektin e politikave aktive të punësimit mbi nivelin e përgjithshëm të punëzënies dhe papunësisë. Analiza empirike konfirmon rolin pozitiv që kanë politikat aktive të tregut të punës në Kosovë apo edhe rajon. Në nivelin makroekonomik rezultatet treguan se shpenzime më të larta të kryera për politikat aktive ndikojnë pozitivisht në uljen e papunësisë së vendeve të përfshira në analizën përgjatë më shumë sesa dekadës së fundit. Gjithashtu, për të identifikuar në nivel mikroekonomik eficiencën e politikave aktive të supozuara se

---

<sup>1</sup> Vendet e EJL, në këtë punim, i referohen gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (EJL6): Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

finalizohen pikërisht me punëzënien e individëve, është bërë një analizë në nivel mikroekonomik bazuar në të dhëna të Anketës së Fuqisë Punëtore. Vlerësimet e marra tregojnë se angazhimi i zyrave të punës drejt grupimeve të targetuara ka rritur gjasat për punëzënie të personave që pikërisht iu përkasin këtyre grupeve, përkatësisht atyre që vijnë më pak nga zonat urbane (apo me qëndrim në zonat rurale), femrave dhe atyre me shkollim të nivelit bazë. Këto rezultate mund të sugjerojnë se do të ishte e përshtatshme që aktiviteti i këtyre zyrave dhe në përgjithësi politikat aktive të rrisin edhe më shumë ndikimin e tyre i cili duket se është në drejtimin e duhur, por me synimin për të rritur masën e individëve të cilët do të mund të përfitonin prej punësimit dhe riaktivizimit në tregun e punës. Gjithsesi, sugjerohet që politikat aktive të mund të shoqërohen edhe me politika të tjera mbështetëse qeveritare në krijimin e një ambienti më nxitës për krijimin e vendeve të punës në ekonomi.

**Fjalët kyçe:** tregu i punës, politikat e punësimit, papunësia, punësimi, programet aktive, programet pasive, legjislacioni për mbrojtjen e punësimit

## **Abstract**

The labor market remains at the core of academic research and political debate in most countries. Labor markets are subject to the macroeconomic, national and international targeting, often make it difficult to describe or measure the effect of employment policies in theoretical or empirical terms. The labor market diversity in different countries often results in employment policies that appear to be unclear and the same may have different effect in different countries going through different development stages. This paper presents a comprehensive theoretical and empirical elaboration of employment policies related to how they affect the labor market performance. Highlighting the labor market developments in the countries in transition, special attention has been paid to the relatively poor performance of employment policies in South Eastern European countries<sup>2</sup>, with particular focus on Kosovo. Using the latest data made available from different national and international sources, firstly we made an analysis of the overall situation of the labor market development trends including unemployment, employment, social cost and the impact of employment policies on the key labor market indicators. Previous findings indicate that the current practice of the South Eastern Europe countries includes very limited assessments and offers only basic knowledge on the efficiency of employment policies, excluding their effectivity during that time. In this context, we have attempted to measure at an aggregate level the effect of active employment policies on the overall level of employment and unemployment. The empirical analysis confirms the positive role of active labor market policies in Kosovo and the region. At a macroeconomic level the results

---

<sup>2</sup> The SEE countries in this paper refer to six countries of the Western Balkans (SEE6): Albania, Kosovo, Bosnia and Herzegovina, North Macedonia, Montenegro and Serbia.

indicated that higher expenditure on active policies do influence positively on reducing unemployment in the countries involved in the analysis for a period longer than the last decade. Also, to identify at a microeconomic level the efficiency of active policies supposed to be finalized with the employment of individuals, an analysis was conducted at the microeconomic level based on the data from the Labor Force Survey. The assessments obtained reveal that the involvement of employment offices for the targeted groups has increased the likelihood for employment of individuals from these groups in particular of those coming from less urban areas (or residing in rural areas), of women and individuals with basic level education. These results may suggest that it would be appropriate for the activity of these offices and in general of active policies to further increase their influence which seems to be running in the right direction however, with the goal of increasing the number of individuals who may benefit from employment and reactivation in the labor market. Nevertheless, it is suggested that active policies may be accompanied by other government-supported policies to create an environment that enables job creation in the economy.

**Keywords:** labor market, employment policies, unemployment, employment, active programmes, passive programmes, employment protection legislation